



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 14 dhjetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_869\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energi**

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparografi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparografi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparografi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 paragrafi 1 nënparografi 1.2, nenin 14, nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Nenin 4, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 12 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-810-2016, të datës 19 maj 2016, për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI, në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit, të datës 30.12.2015 të shoqërisë N.N. "DILLI – COM", me adresë: fshati Bresanë, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës;
- Vendimin nr. V-806-2016, të datës 31 mars 2016, për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë N.N. "DILLI – COM", për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga UJI, në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit;
- Kërkesën/aplikacionin për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI, në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit, nr. prot. 709/16, të datës 21.11.2016 të shoqërisë "N.N. "DILLI – COM", me adresë: fshati Bresanë, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës, dhe
- Kontratat, lejet, pëlgimet dhe vendimit e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcën II. të këtij vendimi,

**në seancën e mbajtur më 14 dhjetor 2016 nxori këtë:**



## V E N D I M

### PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet AUTORIZIMI FINAL shoqërisë N.N. "DILLI – COM" për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI, në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej **0.31 MW**, ngastrat kadastrale me Nr. 2752, 1880, 1881, ZK Bresanë, lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Dragashit.
- II. Vendimi për Autorizim i lëshohet shoqërisë N.N. "DILLI – COM" për dy (2) vite dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin të finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtim.
- IV. Pas finalizimit të projektit, sipas dispozitivit nën pikën III. të këtij vendimi, shoqëria "N.N. "DILLI – COM" do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesin Publik në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku 30 (tridhjetë) ditë para datës së fillimit të operimit gjenerues me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V-810-2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.

### A r s y e t i m

- ZRRE, më 30.12.2015, nga shoqëria N.N. "DILLI – COM" ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI, në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- ZRRE, pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI, më 31 mars 2016 ka Lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminari V-806-2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminari nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminari është lëshuar në afat një (1) vjeçar dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë N.N. "DILLI – COM" do t'i jepet Autorizimi për ndërtim nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminari në Autorizim, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.





- ZRRE, më 21.11.2016, nga shoqëria N.N. "DILLI – COM", ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit, duke i bashkëngitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
  - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe lejeve, pëlgimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundoj versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.*

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, U.D kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPh-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së



## SHTOJCA I

Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 43 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, shoqërisë N.N. "DILLI – COM", me adresë: fshati Bresanë, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës, më 14 dhjetor 2016, i lëshon këtë:

### AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, ngastrat kadastrale me Nr. 2752, 1880, 1881, ZK Bresanë, lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Dragashit.
2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria N.N. "DILLI – COM" që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Ky Autorizim lëshohet për dy (2) vite duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
  - 3.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
  - 3.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato përmjetin e këtij Autorizimi.
5. Zyra e Rregulatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
6. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
7. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundoj me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën II. të këtij Vendimi, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 3 të shtojcës I. të këtij Autorizimi.
8. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do ta pezulloj këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mosrespektimit të kushteve ligjore ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
9. Pala e autorizuar duhet ta njoftoj me shkrim ZRRE-në dhe të kërkoj pëlgimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në projektin që është pjesë e aplikacionit.



## SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e Autorizimin për Ndërtim të shoqërisë N.N. "DILLI – COM", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI në Lumin Bresana, HC Bresana – ZK Bresanë, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, komuna e Dragashit:

- Vendimi 01 nr. 06-4174/4, i datës 31.03.2013 për Dhënien e Pëlqimit për ndërtimin e hidro-centralit të vogël, lëshuar nga Kuvendi Komunal Dragash;
- Pëlqimi Elektroenergjetik - nr. 3500, i datës 27.04.2016, i lëshuar nga KEDS SH.A;
- Pëlqimi Mjedisor - nr. 15/3649/1-379/DMM, i datës 16.10.2015, i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- Pëlqimi Ujor - nr. 1664-2/16, i datës 06.06.2016, i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- AKTVENDIMI – 06 nr. 351-14099/16, i datës 18.11.2016, për lejimin e ndërtimit të hidrocentralit në rrjedhën e lumbit Bresana L-850 m, në ngastrat kadastrale nr. 2752, 1880, 1881, ZK Bresanë, lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Dragashit;
- Certifikata e ngastrave kadastrale dhe kopja e planit.
- Studimi i Fizibilitetit teknik, mjedisor dhe financiar;
- Plani i Biznesit;
- Projekti kryesor.